

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	317/19
Data: Datum: Date:	13.05.19
PRISHTINE/A	



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	4977
Data: Datum: Date:	13.05.19
PRISHTINE/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa nr.1922 të datës 26.02.2019 parashtruar nga operatori i transportit rrugor të udhëtarëve "ARBENI TOURS" SH.P.K. me seli në Ferizaj, kundër vendimit nr.1643 të datës 21.02.2019 mbi shpalljen e nisjeve të lira ndërurbane nëpër regjione respektivisht nisjes në relacionin Shtime- Ferizaj dhe ansjelltas me kohë të nisjes 08:50 - 09:30.

ARSYETIM

Komisioni i emëruar nga Ministri sipas vendimit nr.2259 datë 06.03.2019 pas shqyrtimit të ankesave, verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi respektivisht nenet 5 (paragrafi 4) dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus, poashtu duke pasë parasyshë rrjetin aktual të linjave ndër-urbane, konstaton se nisja e shpallura gjegjesisht nisja 08:50 - 09:30 nuk pengojnë në nisjet e vërtetuara nga MIT-ja në relacionin Shtime - Ferizaj dhe anasjelltas pasi që koha minimale e operimit ndërmjet linjave aktuale në këtë relacion është nga 10 deri 20 minuta, poashtu kjo nisje ka qenë e vërtetuar edhe vite me parë tek operatorët tjerë perkatesisht deri në vitin 2014 por është revokuar, ndërsa nisja (me orarë: 08:50 - 09:30 të shpallura në relacionin e lartëcekur ka një diferencë kohore të operimit në kuadër të llimitit të

Faqe 1 nga 2

Objekti "Gërmia", Rr . Nëna Terezë - 10.000 Prishtinë, Kosovë

<http://www.mit-ks.net>

lartecur perkatesisht ka 10(dhjetë) minuta (provë: rendet e udhëtimit nr: 61/05/2017 Goni Com ; 158/05/2017 Arbeni).

Andaj duke pasë parasysh të cekurat më lartë dhe duke iu referuar legjislacionit në fuqi Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka vlerësuar të domosdoshme shtimin e numrit të nisjeve të reja në mënyrë që të kemi shërbime të mjaftueshme për udhëtarët që frekuentojnë në këtë relacion duke krijuar një treg liberal me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve dhe krijimin e mundësisve më të mëdha për qasje më të shpejtë dhe më lehtë për qytetarët që shfrytëzojnë shërbimet e transportit me autobus.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë vendimi është marrë si në dispozitiv.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë padi në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Parashtruesit të ankesës;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Arkivit të MI -së

